


Raporti Vjetor 2016



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Përmbajtja

MISIONI I PUNËS SË ZYRËS SË KOMISIONERIT	4
1. E DREJTA E INFORMIMIT	6
1.1 Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	6
Trajtimi i ankesave.....	6
Hetime administrative	7
1.2 Monitorimi i zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit	8
1.3 Strategji dhe indikatorë.....	10
1.4 Aktivitete mbi të Drejtën për Informim	11
Konferenca e 2-të Kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/Pyetshtetin.al”	11
Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të shoqërisë civile për zbatimin efektiv të të drejtës për informim.	12
Konferencat Rajonale për të Drejtën për Informim	12
28 Shtator, Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim.....	12
Pjesëmarrje në aktivitete të tjera	12
1.5 Trajnime	12
1.6 Bashkëpunimi me ASPA	13
1.7 Bashkëpunimi me SIGMA/OECD.....	13
1.8 Rankimi ndërkombëtar i Ligjit 119/2014 ”Për të drejtën e informimit”	13
1.9 Projekte dhe implementimi i tyre	13
2. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	14
2.1 Trajtimi i ankesave	14
2.2 Hetime administrative	15
2.3 Njoftimi	17
2.4 Transferimi ndërkombëtar	17
2.5 Rekomandime / Urdhra.....	18
2.6 Standarde Unifikuese në Sektorë të Veçantë.....	19
Rekomandim për Organet e Vetëqeverisjes Vendore	19
Rekomandim në sektorin e Shëndetësisë	19
Rekomandim në sektorin e Arsimit	20

2.7 Sanksione administrative	21
2.8 Procese gjyqësore	22
2.9 Zhvillim i kuadrit ligjor.....	23
Iniciativa ligjore të ndërmarra nga Zyra e Komisionerit	24
Dhënie mendimi për projektakte ligjore, nënligjore dhe projekte	24
2.10 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare	27
2.11 Aktivitete mbi mbrojtjen e të dhënave personale	27
2.11.1 Aktivitete ndërgjegjëse	27
2.11.2 Trajnimi në Programin e Formimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës	27
2.11.3 Trajnimi me prokurorët në kuadër të IPA/2014.....	28
2.11.4 Aktivitete ndërgjegjëse me kontrollues	28
2.12 Google Street View në Shqipëri	28
2.13 Revista“Informim Dhe Privatësi”	28
2.14 Bashkëpunimi	28
Marrëveshje bashkëpunimi	28
Pjesëmarrje dhe kontribute	29
2.15 Integrimi Evropian	29
2.16 Bashkëpunimi Ndërkombëtar.....	30
Certifikimi i Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale	30
Kontributi i Zyrës së Komisionerit në aktivitetet ndërkombëtare	30
Angazhimi në rrjetin GPEN.....	30
Bashkëpunimi me Autoritetet Homologe	31
Mbështetje e Instrumentit TAIEX	31
Forcimi i kapaciteteve	31
3. NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK	32
4. MENAXHIMI BUXHETOR.....	33
4.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore	33
4.2 Menaxhimi financiar	33
Të ardhurat nga sanksionet/gjoha	35
5. PROBLEMATIKA.....	35
6. VIZIONI PËR TË ARDHMEN	35

MISIONI I PUNËS SË ZYRËS SË KOMISIONERIT

Misioni, qëllimi i punës dhe veprimtaria e Zyrës së Komisionerit është garantimi i njohjes së publikut me informacionin publik, të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti, të drejtën për informim dhe të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Në përputhje me këtë mision, veprimtaria e Zyrës së Komisionerit, gjatë vitit 2016 ka qënë më e qartë dhe e konsoliduar, në zbatim të rezolutës të Kuvendit të Shqipërisë, Progres Raportit të Bashkimit Evropian, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe trajnimeve të vazhdueshme. Në këtë këndvështrim, është punuar me prioritate dhe tregues të matshëm.

Miratimi i Rregullores së re të BE-së, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, kërkon angazhim edhe më të madh në reformën evropiane që kërkohet të bëhet në mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit si autoritet i pavarur në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale ka synuar të konsolidojë dhe forcojë rolin e saj të pavarur mbikëqyrës në të dy këto shtylla të rëndësishme.

Me veprimtarinë e saj ndërgjegjësuere, parandaluese dhe sanksionet e vendosura, ka bërë që të ketë rezultate më të mira krahasuar me vitet e kaluara.

Zyra e Komisionerit, megjithëse ende e kufizuar në staf, e ka shtrirë veprimtarinë e saj në të gjithë vendin, duke punuar periodikisht në drejtim të ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve, publikut në përgjithësi, shoqërisë civile e medias, për të identifikuar rëndësinë që merr transparenca dhe privatësia në kohët e sotme, por edhe masat që kërkohet të merren për mbrojtjen e tyre.

Jemi përfaqësuar në aktivitete brenda e jashtë vendit, me një rol aktiv në prezantime, diskutime dhe opinione.

Marrëdhënia ndërkombëtare ka qënë në fokusin e punës së Zyrës së Komisionerit duke i dhënë rëndësi takimeve, anëtarësimeve, raportimeve, por edhe paraqitjes së kërkesave për zhvillime të projekteve të përbashkëta për të rritur nivelin profesional të punonjësve dhe jo vetëm.

Zyra e Komisionerit synon të zhvillojë më tej vizionin e saj, të rrisë dhe të garantojë në nivelet e kërkuara zbatimin e dy të drejtave kushtetuese, të japë zgjidhje praktike në kohë reale si dhe të ndëshkojë shkeljet e ligjit.

Në misionin e Zyrës së Komisionerit bën pjesë edhe shqyrtimi i ankesave në lidhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, një tjetër detyrë e rëndësishme e cila kërkon angazhim, por edhe shtim të kapaciteteve.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit, si një institucion i pavarur raportohet çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë dhe vlerësohet nëpërmjet rezolutave vjetore. Në zbatim të rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Progres Raportit të BE për vitin 2016:


- Është rritur numri i inspektimeve, lidhur me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus të veçantë inspektimet kryesisht me plan tematik.
- Janë thelluar hetimet administrative, kryesisht në sektorë ku përpunohen të dhënat sensitive.
- Janë monitoruar programet e transparencës, në mënyrë të veçantë zbatimin nga organet e qeverisjes vendore.
- Janë rritur masat administrative për shkeljet ligjore të konstatuara.
- Janë trajtuar me kujdes rastet e kërkesave dhe ankesave abuzive, në lidhje me të drejtën e informimit.
- Janë miratuar projekt-akte nënligjore në sektorë të veçantë,
- Jemi fokusuar në ndërgjegjësimin e studentëve, stafit akademik dhe medias si faktor kryesor në bashkëpunim, si dhe publikut në tërësi.
- Është realizuar kualifikimi i thelluar i kapaciteteve institucionale, nëpërmjet trajnimeve ndërkombëtare dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike
- Janë monitoruar zbatimin e rekomandimeve të adresuara subjekteve kontrolluese dhe përpunuese gjatë viteve 2015-2016.
- Është vazhduar me organizimin e trajnimeve, kryesisht në sektorin e medias, sistemin gjyqësor, organet e rendit dhe administratën publike.
- Është rritur ekspertiza për projektakte ligjore, nënligjore dhe projekte të lidhura me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
- Ka nisur procedura për certifikimin e Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Është hartuar projekt/strategjia e Zyrës së Komisionerit për vitet 2017 - 2020.

1. E DREJTA E INFORMIMIT

1.1 Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Trajtimi i ankesave

Gjatë vitit 2016, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën lidhur me zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Numri i ankesave të depozituara pranë Zyrës së Komisionerit ka pësuar rritje të ndjeshme krahasuar me atë të një viti më parë. U depozituan 684 ankesa, prej të cilave 547 janë zgjidhur me ndërmjetësim, për 36 ankesa Komisioneri është shprehur me vendim, 65 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, 7 ankesa kanë rezultuar jashtë afatit dhe 29 ankesa kanë rezultuar të paplota.




Rritja e numrit të ankesave nga organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët është një tregues i mirë i rritjes së ndërgjegjësimit. Gjithashtu, fakti që pjesa më e madhe e ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim tregon efektivitetin e ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit.

684	Ankesa për vitin 2016
574	Ankesa të zgjidhura me ndërmjetësim
65	Ankesa jashtë objektit të ligjit
29	Ankesa të paplota
7	Ankesa jashtë afatit

Pjesa më e madhe e ankesave të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit kanë qenë ankesa të drejtuara nga organizata të shoqërisë civile. Konkretisht **374** ankesa janë depozituar nga OJF dhe 310 janë depozituar nga qytetarët. Vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të ankesave të qytetarëve krahasuar me një vit më parë, ku numri në total i ankesave ka qenë 274. Ankesat kanë qenë kryesisht për institucionet e pushtetit vendor, por ka patur ankesa edhe për institucionet e pushtetit qendror. Mbetet ende problematike moskthimi i përgjigjes nga ana e Autoriteteve Publike brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën informimit”.

Hetime administrative

Zyra e Komisionerit ka realizuar **95** hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Janë dërguar pranë Autoriteteve Publike **273 kërkesa** për parashtrime ndërsa **46 ankesa** vijnë në proces. Gjithashtu, janë dhënë **36** vendime për Autoritetet Publike, prej të cilave **2** vendime, që i përkasin 3 sanksioneve administrative ndaj personave përgjegjës për refuzim për vënie në dispozicion të informacionit publik të kërkuar.



Vlen për t'u theksuar se për herë të parë, me ndërhyrjen e Zyrës së Komisionerit nëpërmjet vendimeve të urdhërimit, janë bërë publike vendimet e organit të prokurorisë për kallëzime penale.

Gjatë këtij viti janë realizuar 31 seanca dëgjimore, ndër të cilat interes të veçantë kanë pasur seancat e realizuara midis përfaqësuesve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, koordinatoreve të të drejtës për informim dhe koordinatoreve të njoftimit dhe konsultimit publik. Objekti i këtyre seancave ishte përmirësimi i implementimit të ligjit nr. “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si një instrument i rëndësishëm që synon nxitjen dhe kultivimin e kulturës së transparencës dhe llogaridhënies, nëpërmjet mekanizmave që ofron ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga ana tjetër, zbatimi i plotë i detyrimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” do të kontribuonte në këtë proces, njëkohësisht edhe për forcimin me efikasitet të punës së administratës publike në shërbim të qytetarëve.

Seancë dëgjimore e një rëndësie të veçantë ka qënë ajo e organizuar midis Shërbimit Informativ Shtetëror dhe BIRN Albania. Objekti i kësaj seance ishte bërja publike e analizave vjetore të ish Sigurimit të Shtetit për vitet 1980-1989. Komisioneri në këtë rast vendosi për urdhërimin e Autoritetit Publik për zbatimin e procedurës së parashikuar në ligj. Në vijim çështja është ankimuar dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi në favor të transparencës dhe bërjes publike të materialeve të kërkuara nga BIRN Albania, konkretisht analizave vjetore të ish Sigurimit të Shtetit për vitet 1980-1989.

Seanca dëgjimore të tjera të rëndësishme për vitin 2016, kanë qënë ato të realizuara ndërmjet BIRN Albania dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për vënien në dispozicion të dokumentacionit mbi praktika të koncesioneve të pakërkuara. Edhe në këto raste Komisioneri ka vendosur në favor të transparencës duke urdhëruar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

1.2 Monitorimi i zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit


Zyra e Komisionerit ka vijuar me monitorimin jo vetëm të faqeve zyrtare të Autoriteteve Publike, por ka kryer inspektime në terren si dhe ka kërkuar informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 119/2014, të tilla si publikimi i programeve të transparencës, caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga ky monitorim i vazhdueshëm ka rezultuar se :


- **154** Autoritete Publike në total kanë miratuar dhe bërë publik programin e transparencës.
- **227** Autoritete Publike kanë caktuar Koordinator për të drejtën e informimit.
- **116** Autoritete Publike kanë krijuar dhe publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve

Gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit ka punuar për të rishikuar databazën e Autoriteteve Publike dhe pikërisht për këtë arsye, me asistencën e ekspertëve të SIGMA, ka hartuar dhe miratuar një udhëzues për përcaktimin e Autoriteteve Publike.

Pas miratimit të këtij dokumenti, në grafikun e mëposhtëm vihet re një ndryshim në numrin e disa prej kategorive të Autoriteteve Publik, p.sh. në vitin 2015 janë paqyruar 145 institucione që bëjnë pjesë në kategorinë e institucioneve qendrore, ndërsa në vitin 2016, pas rishikimit të databazës së institucioneve, pasyrohen 202 institucione që bëjnë pjesë në këtë kategori. Sqarojmë se këto institucione në vitin 2015 bënin pjesë në kategorinë “**Të tjera**”, për pasojë ka ndryshuar edhe numri i institucioneve për këtë kategori.




Nga grafiku i mësipërm vihet re se krahasuar me vitin 2015 kemi një përmirësim në numrin e institucioneve qendrore si dhe institucionet e pushtetit vendor që kanë hartuar programin e transparencës. Gjatë vitit 2016, **46** institucione më shumë se një vit më parë kanë hartuar programin e transparencës.



Nga monitorimi i autoriteteve publike rezulton se mbeten ende problematike hartimi i programeve të transparencës për sistemin gjyqësor, pushtetin vendor, shoqëritë tregtare dhe institucionet qendrore. Gjithashtu, problematikë tjetër është edhe cilësia dhe përditësimi i programeve të transparencës për ato institucione që tashmë kanë një program të tillë.

Ndërsa institucionet e pavarura jo vetëm kanë hartuar dhe miratuar programe transparence, por edhe cilësia e tyre është më e mirë.

Zyra e Komisionerit ka mbledhur të dhëna nga Autoritetet Publike për koordinatorët e të drejtës për informim si dhe për regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve. Në grafikët e mëposhtëm jepen të dhëna krahasimore me vitin 2015 për numrin e koordinatorëve dhe numrin e regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve.



Krahasuar me një vit më parë, siç vihet re edhe nga grafikët, kemi një rritje të konsiderueshme prej 119 koordinatorë të së drejtës për informim dhe 104 regjistra të kërkesave dhe përgjigjeve.

1.3 Strategji dhe indikatorë

Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha grupet e punës lidhur me zbatimin e masave të parashikuara në strategjinë ndërsektorale antikorruption si dhe indikatorët që ka detyrim për të përmbushur në strategjinë ndërsektorale për reformën në administratën publike. Indikatori i cili duhet të realizohet nga Zyra e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale është, **“Përmirësim i zbatimit të ligjit për qasje në informacion”**. 50% e institucioneve të administratës shtetërore mbajnë një regjistër të dokumenteve dhe bazës së të dhënave, dhe të paktën 50% të kërkesave për informacion trajtohen në përputhje me nenin 15 të ligjit nr.119/2014.

Në bashkëpunim me përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian, u dakordësua një listë me Autoritete Publike që do monitorohet dhe raportohej ky indikator i strategjisë antikorruption. Lista e Autoriteteve Publike do të përditësohet për vitet e tjera të monitorimit.

Nga monitorimi i kryer rezulton se nga 128 Autoritete Publike, 77 kanë hartuar dhe miratuar programin e transparencës dhe 78 Autoritete Publike mbajnë një regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve, duke sjellë që pjesa e parë e indikatorit (50% e institucioneve të administratës shtetërore mban një regjistër të dokumenteve dhe bazës së të dhënave) të jetë realizuar në masën 60.1%. Për të mbledhur këtë informacion, Zyra e Komisionerit ka komunikuar me të 128-të institucionet, duke i kërkuar që të dërgojnë pranë saj regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve si dhe të vetëdeklarojnë mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore në përputhje me nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga përgjigjet e marra nga 78 Autoritete Publike rezulton se për vitin 2016 janë trajtuar **14314** kërkesa për informacion dhe vetëm 626 prej tyre janë refuzuar, çka do të thotë që vetëm 4.3% e kërkesave është refuzuar duke sjellë që pjesa e dytë e indikatorit të jetë realizuar në masën **95.7%**.

Në këtë kontekst është marrë pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për të raportuar mbi ecurinë e indikatorit. Është marrë pjesë në takimin e 6-të, të grupit të posaçëm në lidhje me reformën në administratën publike. Në këtë takim është raportuar mbi zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” si dhe për të gjithë veprimtarinë që ka kryer Zyra e Komisionerit gjatë periudhës korrik 2015 - shkurt 2016. Mbetet për t’u realizuar ngritja e “Regjistrin Kombëtar të Kërkesave”, parashikuar me fondet e suportit buxhetor të BE.

1.4 Aktivitete mbi të Drejtën për Informim

Konferenca e 2-të Kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/Pyetshtetin.al”

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros, organizoi Konferencën e 2-të Kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/Pyetshtetin.al”. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, vendore dhe të sistemit të drejtësisë nga i gjithë vendi. U prezantua një analizë e detajuar e implementimit të deritanishëm të ligjit “Për të drejtën e informimit” si dhe u prezantua portali “Pyetshtetin.al”.

Nëpërmjet këtij portali synohet rritja e aksesit të qytetarëve në dokumentat zyrtare të administratës publike.

Kjo platformë u ofron qytetarëve dhe grupeve të interesit mundësi të shumta për ushtrimin e të drejtës së tyre për t’u informuar me dokumentat zyrtare. Në portal mund të konsultohet lehtësisht programi i transparencës dhe lista e koordinatorëve të Autoriteteve Publike, ndërsa në platformë është përfshirë edhe regjistri kombëtar i kërkesave për informim të regjistruara prej tyre .

Në këtë Konferencë morën pjesë Komisioneria Skoceze dhe Komisioneria Kroate e të Drejtës për Informim, të cilat zhvilluan një sesion trajnimi për koordinatorët.

Me qëllim rritjen dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe promovimin e portalit “Pyetshtetin.al” është realizuar një spot televiziv i cili është transmetuar në të gjitha televizionet kombëtare në Shqipëri si dhe një fletëpalosje e veçantë me 10 hapat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim.

Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të shoqërisë civile për zbatimin efektiv të të drejtës për informim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zhvilloi tryezën e rrumbullakët “Nxitja e bashkëpunimit për një zbatim sa më efektiv të së drejtës për informim”. Në të ishin të ftuar përfaqësues të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, me të cilët u diskutua për format dhe mënyrat ku OJF mund dhe duhet të ndikojnë për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Konferencat Rajonale për të Drejtën për Informim

Zyra e Komisionerit ka organizuar 4 konferenca rajonale në qytetin e Elbasanit, Gjirokastrës, Beratit dhe Kukësit me temë “*E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës*”. Aktivitetet kishin për qëllim, që në kuadër të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore nga zbatimi i reformës administrativo-territoriale, institucionet e pushtetit vendor si dhe ato të pushtetit qendror në nivel vendor të njiheshin me detyrimet që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

28 Shtator, Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim

Kësaj iniciative promovuese për herë të parë këtë vit iu bashkua edhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjëse. Në mbrëmje, në një pjesë të fasadës ballore të Muzeut Kombëtar dhe asaj përballë Hotel Tirana International u shfaqën të projektuara parimet e ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe të drejtat që gëzojnë qytetarët. Synimi i këtij aktiviteti ishte t’i shërbejë qëllimit të ndërgjegjësimin të qytetarëve në lidhje me të drejtat e tyre.

Në këtë ditë edhe operatorët e telefonisë celulare iu bashkuan nismës së Komisionerit duke dërguar gjithashtu një mesazh ndërgjegjëses për abonentët e tyre mbi të drejtën e qytetarëve për t’u pajisur me informacion publik.

Pjesëmarrje në aktivitete të tjera

Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë në aktivitete të realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Politike, Qendra Res Publica, InfoCIP, Birn Albania, Lëvizja Mjaft, etj. Në këto takime janë prezantuar rezultatet e monitorimeve të kryera nga këto organizata të shoqërisë civile, mbi zbatimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kryesisht nga pushteti vendor.

1.5 Trajnime

Në bashkëpunim me Qendrën e Informimit të BE-së janë organizuar 3 takime me studentët e gazetarisë të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Shkodrës dhe Universitetit të Elbasanit. Qëllimi i këtyre aktiviteteve informuese ka qenë rritja e ndërgjegjësimin të gazetarëve të

ardhshëm mbi transparencën e autoriteteve publike, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me synim garantimin e një media të lirë dhe të pavarur.

Është realizuar trajnim dy ditor me Komisioneren Kroate dhe ekspertin e SIGMA/OECD, për të diskutuar mbi “Udhëzuesin e Koordinatorit të të Drejtës për Informim” dhe për “Instrumentin e vetëvlerësimit të punës së Autoriteteve Publike”. Në ditën e dytë të këtij trajnimi u ftuan të merrnin pjesë koordinatori i Këshillit të Ministrave, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave si dhe Autoritetit të Konkurrencës, institucione të përzgjedhur për realizimin e projektit pilot.

1.6 Bashkëpunimi me ASPA

Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike janë organizuar 10 trajnime, në të cilët kanë marrë pjesë 335 nëpunës civil në periudhe prove, të ministrive dhe institucioneve të varësisë. Është realizuar edhe një trajnim me 35 nëpunës civil të ILDKPKI.

Është realizuar trajnim 3 ditor i organizuar nga TAIEX, mbi direktivën e BE-së për ripërdorimin e informacionit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte diskutimi në nivel ekspertësh dhe përfitimi i eksperiencave ndërkombëtare me qëllim transpozimin e kësaj direktive.

1.7 Bashkëpunimi me SIGMA/OECD

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është pjesë e vlerësimit të SIGMA/OECD (Support for Improvement in Governance and Management – Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit/ Organisation for Economic Co-operation and Development – Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin).

1.8 Rankimi ndërkombëtar i Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Qendra për Ligj dhe Demokraci dhe AccessInfo Europe janë dy organizata ndërkombëtare të cilat merren me rankimin ndërkombëtar të të drejtës për informim. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, masat e marra nga Zyra e Komisionerit për implementimin e tij si dhe progresi i bërë për të arritur standardet më të mira ndërkombëtare lidhur me transparencën, kanë sjellë rankimin e ligjit nga vendi i 85 (rankimi i ligjit 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit dhe dokumentet zyrtare”) në vendin e 6 në botë.

1.9 Projekte dhe implementimi i tyre

Gjatë vitit 2016 përfundoi bashkëpunimi midis Zyrës së Komisionerit dhe ekspertëve të SIGMA/OECD. Nga ky bashkëpunim u hartuan dy udhëzues.

- Udhëzuesi “Autoritetet Publike në kuptim të ligjit nr. 119/2014”.
- Udhëzuesi “Për koordinatorët e të drejtës për informim”.

Gjithashtu nga ekspertët e SIGMA/OECD u realizua trajnim për stafin e Zyrës së Komisionerit.

Në këtë vit kalendarik u përcaktuan aktivitetet e projektit të binjakëzimit antikorruption, midis Shtetit Shqiptar dhe Konsorciumit Gjermani-Austri. Për Zyrën e Komisionerit këto aktivitete do të fillojnë të implementohen në muajin shkurt 2017.

2. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

2.1 Trajtimi i ankesave


Gjatë vitit **2016** janë paraqitur rreth **150** ankesa. Prej tyre, **94** ankesa kanë rezultuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të ankesave janë zhvilluar sipas rastit inspektime administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm dhe janë ndjekur të gjitha hapat procedurale si komunikim i vazhdueshëm me subjektet ankues dhe kontrollues në kuadër të mbledhjes së informacionit.

Ankesat i kanë takuar kryesisht:

- Publikimit të të dhënave personale në media dhe në faqet zyrtare në internet të kontrolluesve;
- Përhapjes së paligjshme të të dhënave personale nga institucionet publike (Policia e Shtetit, ZRPP, MAS etj);
- Ushtrimit të të drejtës për akses së subjekteve për korrigjim/ fshirje të të dhënave personale;
- Vendosjes së kamerave në ambiente publike;
- Marketingut të drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës telefonike.

Edhe gjatë këtij viti, një numër i madh ankesash janë paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nëpërmjet postës elektronike të vendosur në dispozicion të subjekteve të të dhënave *info@idp.al* apo edhe numrit të gjelbër. Kjo ka bërë të mundur komunikimin e shpejtë edhe të drejtpërdrejtë me subjektet, duke lehtësuar procedurën e zgjidhjes së ankesave.



2.2 Hetime administrative

Gjatë këtij viti janë kryer **179** inspektime në *terren* dhe *online*.


- Inspektimet online janë kryer në organet e vetëqeverisjes vendore, në **61** bashkitë të cilat ofrojnë shërbime nëpërmjet proceseve që përfshijnë mbledhjen, grumbullimin dhe komunikimin e të dhënave personale.
- Inspektimet janë iniciuar si në bazë të ankesave po ashtu edhe nga vetë Zyra e Komisionerit. Janë kryer **118** inspektime administrative në terren, që korrespondojnë me **84** kontrollues privat dhe **34** publik.
- Zyra e Komisionerit e ka shtrirë kontrollin administrativ edhe në **34** kontrollues të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rrethe të ndryshme të Shqipërisë.
- Kontrollet administrative janë kryer në këto sektorë:
 - Arsimi parauniversitar (Drejtori Arsimore Rajonale);
 - Media (inspektime mbi baze ankesash);
 - Telekomunikacion, (procesi i shkatërrimit të të dhënave personale);
 - Marketingu i drejtpërdrejtë;
 - Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
 - Në bazë ankese në zyrat e përmbarimit privat.
 - Shëndetësi (spitale, klinika dhe laboratorë mjeksor privat si dhe spitale rajonale dhe qendra spitalore shtetërore);
 - Agjensi turistike;
 - Hoteleri;
 - Agjenci private punësimi.

Objekt i hetimit ka qenë “Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”. Pas shqyrtimit të materialeve përkatëse administruar në dosje, janë zhvilluar dhe përfunduar **57** seanca dëgjimore, pas të cilave është dalë me aktet përkatëse nga Zyra e Komisionerit.

Seancat dëgjimore janë zhvilluar pasi kontrolluesit janë njoftuar paraprakisht dhe në respektim të të drejtës së subjekteve për t’u dëgjuar në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” përpara marrjes së vendimit përfundimtar.



Hetimet administrative janë realizuar kryesisht në kontrollues me seli në Tiranë, por, edhe në disa rrethe të tjera të vendit, si Korçë, Pogradec, Fier, Vlorë, Berat dhe Shkodër.




Grafiku i mësipërm pasqyron trendin e hetimeve administrative në tre vitet e fundit

2.3 Njoftimi

Gjatë vitit 2016, në përmbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar **155** subjekte kontrolluese. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri tani ka arritur në **5225**.

Është bërë përditësimi i Regjistrit të Njoftimeve, duke fshirë nga databaza bashkitë dhe komunat të cilat janë shkrirë pas miratimit të ndarjes së re administrative territoriale.

Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese është **5169**.



2.4 Transferimi ndërkombëtar


Është ndjekur me përparësi monitorimi i procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave, kryesisht në sektorë strategjikë si telefoni, banka, në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve.

Gjithashtu, me indicie nga plotësimi i Formularëve të Njoftimit, në rastet ku është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm është kërkuar informacion shtesë nga kontrolluesit dhe më tej janë shqyrtuar praktikat përkatëse të transferimeve.

Janë trajtuar gjithsej **31** praktika nga të cilat:

- janë dhënë **13** vendime;
- për **11** praktika janë kthyer pergjigje;
- **7** praktika vijojnë të jenë ende në proces trajtimi.

Praktika të trajtuara për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale		31
Vendime për transferim të dhënash personale		13
Përgjigje		11
Praktika ende në proces shqyrtimi		7



Nga grafiku i mësipërm vërehet rritje në numrin e vendimeve të dhëna.

2.5 Rekomandime / Urdhra

Komisioneri në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, është shprehur me **99** Rekomandime për kontrollues publikë dhe privatë. Janë dhënë **70** rekomandime për subjekte publike dhe **29** rekomandime për subjekte private.

Zyra e Komisionerit është shprehur me **2** Urdhra për “Ndalimin e përpunimit dhe grumbullimit të mëtejshëm të të dhënave dhe shkatërrimin e menjëhershëm të tyre të grumbulluar në mënyrë të paligjshme”, dhënë kontrolluesit publik dhe atij privat. Në këtë kontekst, nëpërmjet rekomandimeve dhe urdhrave është synuar të ndërgjegjësohet çdo kontrollues i të dhënave për të kryer përpunime në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pa cënuar privatësinë e individit.

2.6 Standarde Unifikuese në Sektorë të Veçantë

Nisur nga eksperiencia pozitive e një viti më parë ku Rekomandimet Unifikuese të Komisionerit rezultuan të suksesshme në implementim, edhe në këtë vit raportimi Komisioneri ka vijuar me dhënien e Rekomandimeve të kësaj natyre.

Rekomandim për Organet e Vetëqeverisjes Vendore

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të impaktit që ka mbi qytetarët në lidhje me ushtrimin e detyrave funksionale, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse nga ana e kontrolluesve që veprojnë në këtë sektor.

Riorganizimi i këtij sektori pas reformës territoriale, solli në vëmendje të Zyrës së Komisionerit nevojën e ushtrimit të kontrollit në këtë sektor. Pas kontrollit dhe konstatimit të shkeljeve u vlerësua dhënia e një rekomandimi unifikues i cili synon të veprojë në të gjithë sektorin duke passjellë unifikim të veprimtarisë në përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Kryesisht, rekomandimi ka konsistuar në:

1. Ndërmarrjen e masave për të publikuar “Politikat e privatësisë” si elementi bazë në ushtrimin e të drejtës për informim të çdo subjekti;
2. Ndërmarrjen e masave për të plotësuar njoftimin pranë zyrës së komisionerit si detyrimi ligjor primar për të nisur më tej përpunime të të dhënave personale;
3. Zbatimin e kriterëve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore sa i përket publikimit të të dhënave personale të subjekteve që përfitojnë ndihmë ekonomike, nxënës që marrin bursë studimi, etj.

Rekomandim në sektorin e Shëndetësisë

Sektori i Shëndetësisë është një ndër sektorët ku përpunohet relativisht numër i lartë i të dhënave personale. Për shkak të specifikave të punës që ky sektor ka, dominon mbledhja e të dhënave personale dhe kryesisht atyre sensitive. Kontrolli administrativ në këtë sektor synoi të ushtrojë hetim të thelluar mbi zbatimin e ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Në përfundim të hetimit, pas konstatimit të shkeljeve, Komisioneri vlerësoi dhënien e një rekomandimi për institucionin qendror Ministrinë e Shëndetësisë, nën argumentin se kjo e fundit me cilësinë e mbikëqyrësit apo edhe të rregullatorit do të mund të përmirësojë në kohë problematikat e identifikuara në institucionet e varësisë, me fokus të veçantë konsolidimin e punës për trajtimin e të dhënave të pacientëve në përputhje me çfarë parashikon dhe kërkon legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kryesisht, Rekomandimi ka konsistuar në:

1. Marrjen e masave për të realizuar detyrimin e informimit të subjekteve të të dhënave, në institucionet e kujdesit shëndetësor publik;
2. Marrjen e masave për të realizuar detyrimin e njoftimit dhe bërë përditësimin e tij;

3. Marrjen e masave për hartimin e aneks kontratave, sipas standarteve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve – pacientë;
4. Marrjen e masave në sistemimin dhe arkivimin sipas kushteve normale të kartelave klinike, të cilat mbartin të dhëna jetike për qytetarët;
5. Marrjen e masave për të realizuar Deklaratat e Konfidencialitetit, për të gjithë punonjësit e kujdesit shëndetësor të cilët aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës në institucionet e kujdesit shëndetësor publik.


Rekomandim në sektorin e Arsimit

Në të njëjtën linjë, Komisioneri ka vijuar të krijojë këtë standard të unifikuar edhe me sistemin arsimor, si kontrollues i quajtur përpunues potencial i të dhënave personale dhe atyre sensitive, të dhëna që përfshijnë kategoritë nxënës, studentë, staf pedagogjik apo edhe administratën në përgjithësi në këtë sektor.

Edhe në këtë sektor, pas konstatimeve të problematikave, është rekomanduar kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit për të vijuar më tej me ndjekjen dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjithë sektorët që ajo ka në varësi të saj, mbikëqyr dhe operon me ta.

Kryesisht, rekomandimi ka konsistuar në:


1. Marrjen e masave për të asgjësuar të dhënat sensitive për nxënësit që mbartin këto të dhëna;
2. Marrjen e masave për të realizuar detyrimin e informimit të subjekteve të të dhënave, në të gjitha institucionet arsimore;
3. Marrjen e masave për të realizuar detyrimin e bërjes së përditësimit të njoftimit, për të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar;
4. Marrjen e masave për pajisjen me rregullore të posaçme të mbrojtjes së të dhënave personale;
5. Marrjen e masave për të realizuar Deklaratat e Konfidencialitetit për të gjithë punonjësit e institucioneve arsimore, të cilët aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës në këto institucione;
6. Në parashikimet e mundësisë së pajisjes me adresa zyrtare për postën elektronike të punonjësve dhe në pamundësi të saj, pajisjen e çdo departamenti të institucioneve arsimore me adresë zyrtare;
7. Në rishikimin e mundësisë së hartimit të një akti normativ, mbi pajisjen e shtetasve me dëftesa pjekurie ose kopje të tyre.



2.7 Sanksione administrative

Sipas parashikimeve dhe procedurave ligjore, Zyra e Komisionerit pas ushtrimit të hetimeve administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm publik dhe privat, kryesisht ose mbi bazë ankesash të subjekteve të të dhënave ka vendosur sanksione me gjobë. Kjo, në rastet kur shkeljet kanë qenë serioze, të përsëritura, apo në rast mospërbushjeje të rekomandimeve/urdhreve të Komisionerit, përpara marrjes së vendimit me sanksion.

Në mbyllje të procedurave hetimore, Zyra e Komisionerit ka dalë me **46** vendime të cilat korrespondojnë me **97** sanksione administrative. **24** vendime me 46 sanksione i adresohen kontrolluesve publik, ndërsa **22** vendime me **51** sanksione i adresohen kontrolluesve privat.



Siç pasqyrohet edhe në grafikun e mësipërm për vitin 2016 numri i sanksioneve është gati dyfishuar.




2.8 Procese gjyqësore

Në lidhje me vendimet e Komisionerit dhe zbatimin e tyre, bazuar në numrin e vendimeve të lëna në fuqi nga gjykata dhe vendimet e zbatuara në mënyrë vullnetare, konstatohet një ecuri pozitive.

- Janë ankimuar 14 vendime;
- Janë gjykuar e lënë në fuqi 11 vendime;
- Janë ende në proces gjyqësor 4 vendime;
- Janë ekzekutuar vullnetarisht 16 vendime;
- Janë ekzekutuar nëpërmjet shërbimit përmbarimor 14 vendime;
- Janë ekzekutuar nëpërmjet shërbimit përmbarimor edhe 5 vendime të mbartura nga viti 2015;
- Janë në proces ekzekutimi 9 vendime nga viti 2016 dhe 6 vendime nga viti 2015.

Janë dhënë 36 vendime në fushën e të drejtës për informim. Mbi ecurinë e zbatimit të tyre në shifra konkrete:

- Janë dhënë 2 vendime me gjobë që i përkasin 3 sanksioneve;
- Janë ankimuar 5 vendime;
- Janë lënë në fuqi 2 vendime;
- Është pranuar pjesërisht 1 vendim;
- Janë rrëzuar 2 vendime;
- Është ekzekutuar 1 vendim me sanksion gjobë i mbartur nga viti 2015.



Aktualisht vijojnë të jenë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit 8 vendime që i përkasin të dy fushave të veprimtarisë së Zyrës.

2.9 Zhvillim i kuadrit ligjor

Në disa akte normative të miratuara gjatë këtij viti, të konsultuara me Zyrën e Komisionerit, është parashikuar edhe kontributi i kësaj të fundit për nxjerrjen e akteve nënligjore që prekin fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

1. **Udhëzimi** nr. 44/2016 i Komisionerit “Për kushtet, kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 60/2016”, detyrim i parashikuar në ligjin “Për Mbrojtjen e sinjalizuesve”.
2. **Udhëzimi** i përbashkët nr. 515, datë 27.09.2016 i Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga Rojet Kufitare”, në zbatim të ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”.

Në zbatim të nenit 8, 21 dhe 31/ç të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar janë hartuar dhe miratuar akte nënligjore, vendime dhe udhëzime që i përkasin sektorëve të veçantë si:

1. **Vendimi nr. 7**, datë 09.02.2016 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

2. **Vendimi nr. 8/2016** i Komisionerit “Për përcaktimin e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.
3. **Udhëzimi nr. 43**, datë 09.02.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 21, datë 24.09.2012 “ Për Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë së të Dhënave Personale të Përpunuara nga Kontrolluesit e Mëdhenj”.
4. **Udhëzimi nr. 45, datë 31.10.2016** “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 3/2010 “Për përpunimin e të dhënave personale në sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

Janë miratuar edhe dokumente në ndihmë të kontrolluesve si më poshtë :

1. **Udhëzuesi** “Për përcaktimin e kontrolluesve të cilët kanë detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat janë përgjegjës, për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit”.
2. **Udhëzuesi** “Mbi përpunimin e të dhënave sensitive dhe marrjen e autorizimeve”.

Iniciativa ligjore të ndërmarra nga Zyra e Komisionerit

Me iniciativë të Zyrës së Komisionerit, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë u krye procedura për propozimin e një ndryshimi në ligjin nr. 9288/2004 “Për Ratifikimin e Konventës “Për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”. Aktualisht ligji është miratuar në Kuvend.

Me iniciativë të Zyrës së Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, është në proces aderimi Konventa nr. 205/2009 e Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumente zyrtare”.

Dhënie mendimi për projektakte ligjore, nënligjore dhe projekte

Është dhënë mendim ligjor për **11** p/ligje, **4** p/vendime, **4** p/marrëveshje bashkëpunimi, **1** projekt si dhe janë dhënë **70** opinione ligjore dhe përgjigje për kërkesa të paraqitura nga kontrollues publikë e privatë.

Ndër to përmendim:

Projektligjin “Për Sinjalizuesit”, dërguar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Projektligjin “Për kontrollin kufitar”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligjin “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Mbi zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129/2009 “Për Gjendjen Civile”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligjin “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë intelektuale”, i ndryshuar, dërguar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Projektligjin “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Projektvendimin “Për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të koncesionit/partneritetit publik privat”, dërguar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Projektvendimin “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, dërguar nga Këshilli i Ministrave.

Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedurës së plotësimit dhe dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe dokumenteve shoqëruese të tij, për administrimin e tyre nga autoritete përgjegjëse dhe për një shtesë buxheti Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2016”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projekt marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Gjeorgjisë “Për bashkëpunim në luftën kundër krimit”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.


Projekt marrëveshjen “Për përhapjen e të dhënave personale të kandidatëve për student në IAL për vitin akademik 2016 – 2017 nga Agjencia Kombëtare e Provimeve tek Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik”, dërguar nga AKP.

“Projektin koncensionar të implementimit të sistemit të targave me çip (RFID)”, dërguar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Janë dhënë opinione ligjore për dokumente të rëndësishëm, ardhur nga institucione të ndryshme.

- ✚ Dokumentin për “Publikimi i të dhënave në “Regjistrin Elektronik të Koncesionit/Partneritet Publik Privat”, dërguar nga Agjencia e Trajtimit të Konkencioneve.
- ✚ Dokumentin për “Përpunimi i të dhënave personale të një kategorie të caktuar subjektesh nga Komisioni Hetimor Parlamentar”, dërguar nga Këshilli i Ministrave..
- ✚ Dokumentin për “Publikimi në media i të dhënave personale nga sistemi TIMS”.
- ✚ Dokumentin për “Përpunimi i të dhënave personale në sistemin TIMS të personave që rezultojnë të dënuar dhe që janë amnistuar”.
- ✚ Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015–2017, dërguar nga Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).
- ✚ Deklaratën e konfidencialitetit dhe marrëveshjet e nënshkruara nga “MAS” dhe “Education Testing Service Global BV”, dërguar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.
- ✚ Dokumentin e Shërbimit elektronik e-tax të përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, është dhënë asistencë për kontrollues të tjerë publikë dhe privatë lidhur me projekt rregulloret e posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale, lidhur me përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV, për vërtetimet e gjendjes gjyqësore, rreth njoftimit dhe detyrimeve të tjera në kuadër të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përdorimit të “cookies” në faqet e internetit, rreth publikimit në media të të dhënave personale, mbi fshirjet e të dhënave të publikuara në portale të ndryshme online, etj.



2.10 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare

Synimi i këtij procesi është evidentimi i akteve të miratuara të cilat prekin fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe nëse ato janë konsultuar me Zyrën e Komisionerit përpara miratimit të tyre. Aneksi i rendit të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara, që mendojmë se duhet të kishin marrë më parë mendimin e Zyrës së Komisionerit (neni 31/1/a).

2.11 Aktivitete mbi mbrojtjen e të dhënave personale

2.11.1 Aktivitete ndërgjegjëse

Më 28 Janar 2016, në Ditën Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve të konkursit “Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet”. Ky aktivitet ishte iniciativë e Zyrës së Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Në këtë aktivitet morën pjesë 21 shkolla 9-vjeçare nga 17 qytete të vendit, nxënësit e të cilave paraqitën mbi 500 punime në të dy kategoritë. Punimet më të mira u përmblodhën në një botim të veçantë i cili iu shpërnda institucioneve arsimore.

Gjatë vitit 2016, Zyra e Komisionerit zhvilloi fushatën ndërgjegjëse “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grup-mosha 15-18 vjeç” e cila u shtri në të gjithë territorin e vendit me 36 takime në shkollat e mesme të përgjithshme të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Fierit, Gjirokastrës, Beratit, Korçës, Elbasanit, Lezhës, Shkodrës, Kukësit, Lushnjës, Pogradecit, Tepelenës, Përmetit dhe Sarandës dhe përfundoi në dhjetor të këtij viti. Në përfundim të kësaj fushate, u botua studimi “Privatësia dhe Siguria e të Dhënave Personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale”. Me qëllim ndërgjegjësimin e kësaj grupmoshe Zyra e Komisionerit ka publikuar dhe tri fletëpalosje të veçanta për mbrojtjen e privatësisë. Në këto takime janë prezantuar edhe dy video të realizuara nga Zyra e Komisionerit me qëllim respektimin e privatësisë nga nxënësit si dhe video këshilluese për mësuesit se si të mbrojnë të dhënat personale.

Gjithashtu, janë organizuar takime informuese me studentë dhe staf akademik të Universiteteve “Ismail Qemali” në Vlorë, “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, “Fan Noli” në Korçë dhe Fakulteti Ekonomik në Sarandë mbi aspektet ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, raste praktike dhe roli i institucionit tonë në procesin e trajtimit të ankesave të qytetarëve.

2.11.2 Trajnimi në Programin e Formimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës

Në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, Shkolla e Magjistraturës me kontributin e Zyrës së Komisionerit, zhvilloi 2 seminare trajnues me temë “Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”. U trajtuan tematika të mbrojtjes së të dhënave personale në sistemin gjyqësor, veçanërisht anonimizimit të tyre, procesit të hetimit administrativ edhe në këndvështrimin e Kodit të ri të Procedurës Administrative, praktikave të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe risive pas hyrjes në fuqi të Rregullores së re të Mbrojtjes së të Dhënave

Personale në Bashkimin Evropian, që reformon dhe zgjeron fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

2.11.3 Trajnimi me prokurorët në kuadër të IPA/2014

Në kuadër të IPA/2014, me mbështetjen e GIZ, u organizua në Tiranë dhe Sarandë nga EUROJUST dhe Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor trajnimi me prokurorët në nivel vendi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit në këtë trajnim prezantoi kryesisht rregullat që duhen ndjekur dhe zbatuar mbi përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në këtë sektor.

2.11.4 Aktivitete ndërgjegjëse me kontrollues

Zyra e Komisionerit ka zhvilluar trajnim në Policinë e Shtetit me pjesëmarrjen e zëdhënësve të Drejtorisë së Policisë së Shtetit në nivel qarku. Në këtë aktivitet janë trajtuar problematika dhe raste konkrete të fushës së mbrojtjes së privatësisë dhe asaj të të drejtës për informim.

2.12 Google Street View në Shqipëri

Prej muajit prill 2016, kompania Google ka realizuar fotografimin 360° të rrugëve të qyteteve kryesore, si dhe të zonave turistike e historike të vendit duke ofruar shërbimin e Google Street View edhe në Shqipëri. Për këtë qëllim, kompania Google ka bashkëpunuar me Zyrën e Komisionerit që aktiviteti i përpunimit të të dhënave nëpërmjet këtij aplikacioni të realizohet në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale për respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

2.13 Revista “Informim Dhe Privatësi”

Zyra e Komisionerit, gjatë vitit 2016, filloi botimin periodik 6-mujor të revistës **“Informim dhe Privatësi”**. Në të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur aktivitetet kryesore të institucionit si dhe të rejat e fundit në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Revista ka për qëllim të nxisë akoma më shumë ndërgjegjësimin e qytetarëve për ushtrimin në praktikë të të drejtave të tyre kushtetuese.

2.14 Bashkëpunimi

Marrëveshje bashkëpunimi

Në dhjetor 2016, Komisioneri dhe Rektori i Universitetit të Tiranës, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve. Një nga pikat më të rëndësishme të kësaj marrëveshje është themelimi i Shkollës Dimërore “Informim dhe Privatësi”. Funksionimi i saj ka për qëllim, që njohuritë dhe problematikën në fushat e privatësisë dhe të drejtës për informim, t’i trajtojë në mënyrë më të thelluar. Shkolla synon përgatitjen dhe njohjen e vazhdueshme, sidomos, të studentëve me risitë në këto dy drejtme.

Pjesëmarrje dhe kontribute

Zyra e Komisionerit ka qenë aktive në organizimet e institucioneve dhe shoqërisë civile jo vetëm në pjesëmarrje por edhe nëpërmjet prezantimeve. Në aktivitetin e organizuar nga shoqata **"Together for Life"** në përmbyllje të projektit "Sfidat e të sëmurëve me kancer në sistemin shëndetësor shqiptar", Zyra e Komisionerit prezantoi punimin "Përpunimi i të dhënave shëndetësore/sensitive. Praktika e Republikës së Shqipërisë". Gjithashtu, zyra ka qenë e pranishme në prezantimin e raportit të Këshillit të Evropës mbi "Mbrojtjen e të dhënave personale në gjykatat shqiptare", organizimet e "Partners Albania" në disa rrethe të vendit, me përfaqësues të biznesit, shoqërisë civile dhe medias për njohjen dhe zbatimin e ligjit nr. 60/2016 *"Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve"* si dhe në Konferencën "Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave "Projektligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë".

2.15 Integrimi Evropian

Në kuadër të Integritimit Evropian, kontributi i Zyrës së Komisionerit në këtë proces të rëndësishëm, konsiston:

- ✓ Në kuadër të takimit të VIII –të, të Nënkomitetit për Çështjet e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë si dhe për takimin e VII-të, të Komitetit të Stabilizim Asociimit të (MSA).
- ✓ Mbi kontributin e dytë të Republikës së Shqipërisë për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016 për kapitullin "Kriteri Politik" dhe kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore".
- ✓ Pranë Delegacionit të BE-së në kuadër të rekomandimeve të lëna në Progres Raport për vitin 2015 për Shqipërinë (sot Raporti i Shtetit), por edhe mbi zhvillimet e përgjithshme të Zyrës së Komisionerit, krahasimisht me periudhën raportuese të mëparshme.
- ✓ Në raportin e 19-të vjetor për vitin 2015, pranë Sekretariatit të Grupit të Punës së Nenit 29 (artikulli 29 i Direktivës 95/46 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit), në lidhje me zhvillimet më të rëndësishme të Zyrës së Komisionerit si dhe me disa raste praktike (case laws).
- ✓ Mbi aktivitetet e zhvilluara për vitin 2015-2016 pranë Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (ETS 108) të Këshillit të Evropës.
- ✓ Pranë Sekretariatit të Grupit Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit), mbi zhvillimet më të rëndësishme për vitin 2015 të Zyrës së Komisionerit.

2.16 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Certifikimi i Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale

Zyra e Komisionerit inicioi gjatë Mbledhjes së 104-t Plenare të Grupit të Punës së Nenit 29-të bisedimet me përfaqësues të Njesisë për Mbrojtjen e të Dhënave, të DG Just pranë KE-së, për nisjen e procedurave për aplikimin nga ana e Republikës së Shqipërisë për përfitimin e Statusit të Vendit me Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave. Për këtë qëllim, në datën 21 qershor 2016 u zhvillua një takim dypalësh midis përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit me përfaqësues të Njesisë për Mbrojtjen e të Dhënave të DG Just-it në Bruksel, ku u diskutua mbi modalitetet e aplikimit. Ky i fundit u krye zyrtarisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, aplikim në të cilin Zyra e Komisionerit bashkëlidhi një raport gjithëpërfshirës dhe të detajuar të kuadrit ligjor dhe situatës së mbrojtjes së të dhënave në Republikën e Shqipërisë.

Kontributi i Zyrës së Komisionerit në aktivitetet ndërkombëtare

Konferenca Ndërkombëtare e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) zhvilloi edicionin e 38-të të saj, me moton “Sfidat e reja të privatësisë”, ku u diskutua mbi privatësinë e të dhënave, aksesin e institucioneve ekzekutive në të dhënat personale, rolin e teknologjisë, etj. Konferenca miratoi këto dokumente:

1. Rezoluta për miratimin e një kuadri ligjor ndërkombëtar për Edukimin mbi Privatësinë;
2. Rezoluta mbi zhvillimin e indikatorëve të rinj të Rregullores së Mbrojtjes së të Dhënave;
3. Rezoluta mbi mbrojtësit e të drejtave njerëzore;
4. Rezoluta mbi bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e ligjeve të privatësisë.

Zyra e Komisionerit, në cilësinë e anëtarit të Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale prezantoi organizimin e edicionit të 27-të të Takimit të Punës të Praktikave të Veçanta (Case Handling Workshop), i cili u zhvillua në 2015-ën, në Tiranë. Në këtë prezantim u paraqit edhe Handbook-u i hartuar nga Zyra e Komisionerit, i cili u vlerësua dhe publikua në faqen zyrtare të Komisionit Evropian (CIRCabc). Konferenca miratoi këto dokumente:

1. Rezoluta mbi kuadrot e rinj të bashkëpunimit;
2. Rezoluta mbi qarkullimet ndër-kufitare të të dhënave personale.

Angazhimi në rrjetin GPEN

26 Autoritete të Mbrojtjes së të Dhënave, përfshirë Zyrën e Komisionerit, iu bashkuan këtë vit nismës GPEN Privacy Sweep, (GPEN - Global Privacy Enforcement Network - Rrjetit Global të Zbatimit të Legjislacionit të Mbrojtjes së Privatësisë). Qëllimi i kësaj nisme ishte kontrolli i praktikave të kontrolluesve publikë dhe privatë në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, për mënyrën se si u komunikojnë përdoruesve praktikatat e tyre të mbrojtjes së

privatësisë. Në fokus të kontrolleve këtë vit ishin teknologjitë IoT (Internet of Things), pajisjet wearable (fitness trackers), VOD (video on demand), smart TV, smart meters dhe aplikacionet përkatëse në smartphone.

Zyra e Komisionerit kontribuoi në këtë iniciativë me organizimin e kontrolleve të faqeve Web dhe aplikacioneve të ndryshme, si p.sh.: “Komisariati Dixhital”, etj dhe rezultatet e këtyre kontrolleve iu raportuan koordinatorëve të GPEN-it.

Në mbledhjet plenare të **Grupit të Punës së Nenit 29**, organit këshillimor të Komisionit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit përfaqësohet në cilësinë e vëzhguesit. Mbledhja e 104-t Plenare dhe Mbledhja e Jashtëzakonshme “Mbi qëndrimin e përbashkët për Privacy Shield-in dhe vendimin për Mjaftueshmërinë e Nivelit të Mbrojtjes së të Dhënave të SHBA-ve” u përqendruan në përgatitjet për hyrjen në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së dhe vendimit të Komisionit për përshtatshmërinë e nivelit të mbrojtjes së të dhënave në Shtetet e Bashkuara.

Takimi i 33-të i Komitetit Konsultativ (T-PD) të Konventës “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale” (Konventa 108 e KiE), përveç vazhdimësisë së punës në lidhje me dokumente të ndryshme që priten të miratohen gjatë 2017-ës, agjenda e mbledhjes u përqendrua tek modernizimi i Konventës 108 të KiE-së.

Zyra e Komisionerit anëtarësohet në Komitetin Ad Hoc CAHDATA të Këshillit të Evropës dhe përfaqësohet në mbledhjen e saj të parë plenare pas mandatit të marrë, si edhe në Konferencën Ndërkombëtare të KiE-së, për promovimin e Konventës 108 të modernizuar, në Strasburg. Qëllimi i këtij organi Ad Hoc dhe i këtij takimi ishte shqyrtimi i propozimeve dhe ndryshimeve në kuadër të modernizimit të Konventës 108.

Bashkëpunimi me Autoritetet Homologe

Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me autoritetet homologe në shkëmbimin e informacionit, implementimin e marrëveshjeve apo edhe në kuadrin e zbatimit të projekteve, kryesisht me vendet e rajonit. Vlen të përmendet bashkëpunimi me Autoritetin Maqedonas të Mbrojtjes së të Dhënave në lidhje me projektin e përbashkët rajonal, **DeleteMe**, një nismë ku qytetarët mund të gjejnë informacionin teknik të nevojshëm për tu çregjistruar dhe për të fshirë llogaritë dhe të dhënat e tyre personale në rrjete sociale dhe shërbimet më të njohura online.

Mbështetje e Instrumentit TAIEX

Me financimin e plotë të Instrumentit TAIEX, u mundësua organizimi në Tiranë i “Seminarit mbi Median dhe Përputhshmërinë me Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave”, me pjesëmarrjen e disa ekspertëve të mirënjohur ndërkombëtarë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe Medias. Kjo iniciativë u ndërmor si rezultat i detyrave të lëna në Progres-Raportin e vitit 2015 të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të problematikave të shkëljes së të drejtës për mbrojtje të të dhënave personale nga ana e Medias, ashtu si edhe në strategjinë 2014-2017 të Zyrës së Komisionerit, për ndërgjegjësimin e aktorëve të fushës së medias në Shqipëri, për respektimin e standardeve kombëtare dhe evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Forcim i kapaciteteve

Përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përfunduan programin Tailor-made Training (TMT) i cili u mundësua nga “The Netherlands Fellowship Programmes” (Projekti i Shkëmbimit Universitar) të agjencisë EP-Nuffic, pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës dhe u zbatua nga Universiteti Vrije Amsterdam. Në të referuan akademikë e studiues, përfaqësues të Autoritetit hollandez të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, juristë dhe veprimtarë të organizatave jo qeveritare. Njohja integrale me Rregulloren e re të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian, e cila hyn në fuqi në maj të vitit 2018 dhe përmirësimet në raport me Direktivën 95/46, ishin ndër temat kryesore të trajnimit. Ky trajnim është hap drejt konsolidimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative të Zyrës së Komisionerit.

Punonjës të stafit të Zyrës së Komisionerit janë trajnuar në cilësinë e trajnerëve në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky trajnim është paraprirë nga pjesëmarrja në tryezën e Rrumbullakët “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut për administratën publike*”, organizuar nga ASPA me mbështetjen e OSCE si pjesë e projektit “Edukimi i vazhdueshëm mbi të drejtat e njeriut për zyrtarët e Administratës Publike”.

3. NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK

Vazhdon të jetë e ulët ndjeshmëria dhe angazhimi qytetar shprehur nga numri i pakët i ankesave sa i përket zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Janë trajtuar 2 ankesa, në të cilat ankuesit kanë pretenduar në mos konsultimin e projektakteve me publikun. Një ankesë i referohej miratimit të p/ligjit “Për Amnistinë” dhe tjetra p/ligjit “Për të Drejtën e Autorit”.

4. MENAXHIMI BUXHETOR

4.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore

- **Ndjekja dhe zbatimi i praktikave mbi menaxhimin e burimeve njerëzore**

Në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, është ndjekur dhe zbatuar legjislacioni i shërbimit civil, nga procedura e rekrutimit dhe deri në vlerësimet e punës të secilit nëpunës.

Gjatë këtij viti, struktura organizative e Zyrës së Komisionerit nuk pësoi ndryshime edhe pse kërkesat për shtim të kapaciteteve janë bërë prezente gjatë hartimit të kërkesave buxhetore PBA. Mungesa e kapaciteteve bëhet pengesë për realizimin e objektivëve për garantimin e dy të drejtave themelore kushtetuese, objekt i veprimtarisë së Zyrës.

Është përmbushur detyrimi mbi plotësimin e Vetëdeklarimit nga çdo nëpunës i Zyrës së Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Vendimit të Kuvendit nr.17/2016.

4.2 Menaxhimi financiar

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2016, Zyra e Komisionerit ka shpenzuar vlerën buxhetore 203.289 (në mijë lekë). Është realizuar buxheti në tërësi në masën 99.3%, kundrejt planit vjetor. Buxheti i akorduar nuk kanë qenë i mjaftueshëm në zërin *mallra e shërbime të tjera* edhe pse gjatë paraqitjes së kërkesave buxhetore PBA është kërkuar rritje e tij.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet në % çdo kategori shpenzimesh, përkundrejt totalit të buxhetit.





TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT

VITI 2016		000 / lekë			
Nr.	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 mujor	% realizimi kundrejt planit vjetor
1	Paga	32300	15.8%	31.979	99%
2	Sigurime shoqërore	5200	2.5 %	5075	97.6%
3	Mallra e shërbime të tjera	17660	8.65%	17340	98.2%
4	Investime	149000	72.8%	148.401	99.6%
5	Transferta te buxhetet familjare	410	0.2%	410	100%
6	Kuotizacion	100	0.05%	85	85%
	Totali	204.670	100%	203.290	99.3 %

✓ Të dhënat e mëposhtme janë tregues i realizimit buxhetor të tri viteve kalendarike.



Të ardhurat nga sanksionet/gjoha

- Për vitin 2016, sanksionet e vendosura janë në shumën 5.340 (në mijë lekë).
- Për këtë vit, vlera e arkëtuar është në shumën 3.148 (në mijë lekë).
- Janë arkëtuar edhe 450 (në mijë lekë) të pa arkëtuara nga vlera 2.020 (në mijë lekë) e mbartur nga viti 2015.

Vlera e mbetur për tu arkëtuar (përfshirë edhe vitin 2015) është në shumën 3.762 (në mijë lekë).

5. PROBLEMATIKA

Mbetet ende problematikë:

- Reagimi i Autoriteteve Publike në raport me hartimin dhe publikimin e programeve të transparencës, caktimin e koordinatorëve, krijimin dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.
- Mostrajtimi i kërkesave brenda afatit të përcaktuar në ligj.
- Cilësia dhe përditësi i programeve të transparencës për ato institucione të cilat kanë hartuar një të tillë.
- Mos dërgimi i projektakteve ligjore dhe nënligjore që prekin fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, për mendim.
- Shtimi i burimeve njerëzore dhe shtimi i buxhetit në raport me kompetencat e shtuara të Zyrës së Komisionerit.

6. VIZIONI PËR TË ARDHMEN

Monitorimi dhe mbikëqyrja e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, në disa drejtime.

- ✓ Rritje e transparencës dhe trajtimi në afat i ankesave.
- ✓ Rritje e numrit të kontrolleve dhe hetimeve administrative.
- ✓ Rritje e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike lidhur me garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesin në informacion.
- ✓ Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

Analizë e problematikave dhe përmirësimi i mundshëm i ligjit nr.119/2014.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në disa drejtime.

- ✓ Trajtimi në afat i ankesave.
 - ✓ Rritje e ushtrimit të kontroleve në kontrollues që i përkasin sektorit arsimor dhe atij të kujdesit shoqëror.
 - ✓ Trajtimi cilësor i praktikave për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.
 - ✓ Verifikim i zbatimit të Rekomandimeve dhënë kontrolluesve.
 - ✓ Zhvillim i kuadrit ligjor me fokus miratimin e disa akteve nënligjore në sektorët e shëndetësisë, transportit ajror, përdorimit të CCTV, certifikimit të kontrolluesve, etj.
 - ✓ Rritje e ekspertizës në dhënien e mendimeve ligjore për projektakte ligjore dhe nënligjore;
 - ✓ Përmirësimet e mundshme të ligjit nr. 9887/2008 në përputhje me reformën evropiane;
 - ✓ Ndjekja me përparësi e procesit të certifikimit të Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm i mbrojtjes së të dhënave personale dhe procesit të aderimit në Konventën 205/2009 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në Dokumente Zyrtare”.
-
- ✚ Do të vijojë zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere në të dy fushat e veprimtarisë me institucione publike e private dhe shoqërinë civile;
 - ✚ Do të vijojë bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë dhe shfrytëzimi i instrumenteve të ndryshëm për të forcuar kapacitetet institucionale;
 - ✚ Do të vijohet të aplikohet në MIE dhe organizma të tjerë për përfitim projektesh;
 - ✚ Do të investohet në zhvillimin e infrastrukturës informatike dhe logjistike me përsosjen e databazës së Kontrolluesve, zhvillimin e databazës së Autoriteteve Publike si dhe krijimin e Regjistrisë Kombëtare të kërkesave dhe përgjigjeve të Autoriteteve Publike;
 - ✚ Do të rriten treguesit e performancës institucionale.

FALEMINDERIT

ANEKS Nr.1

➤ Ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim

1. Ligji nr. 38/2016 datë 14.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
2. Ligji nr. 45/2016 “Për Vullnetarizmin”;
3. Ligji nr. 84/2016 datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
4. Ligji nr. 95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
5. Ligji nr. 96/2016 datë 6.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
6. Ligji nr. 97/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
7. Ligji nr. 98/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

➤ VKM të cilat nuk janë paraqitur për mendim

1. VKM nr. 8, datë 11.1.2016 “Për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe individit që merr pjesë në operacione të fshehta”;
2. VKM nr. 64, datë 27.1.2016 “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit”;
3. VKM nr. 191 datë 09.03.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e shërbimeve të punësimit”.
4. VKM nr. 67 datë 01.06.2016 “Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare.” (fl. zyrtare nr. 103/2016);
5. VKM nr. 441 datë 15.06.2016 “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt.” (fl zyrtare nr. 114/2016);
6. VKM nr. 442 datë 15.06.2016 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për personat pa shtetësi dhe lejes së kalimit për të huajt”;
7. VKM nr. 639, datë 7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”;
8. VKM nr. 710, datë 12.10.2016 për miratimin e Rregullores “Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik”.

➤ **Udhëzime të cilat nuk janë paraqitur për mendim**

1. Udhëzimi i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 4 datë 15.02.2016 “Për procedurat në zbatim të ligjit nr. 146/2015 datë 17.12.2015 “Për punëkërkesit”;
2. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8 datë 25.05.2016 “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë për vitin shkollor 2015-2016”;
3. Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 16, datë 3.8.2016 “Për vitin shkollor 2016–2017 në sistemin arsimor parauniversitar”;
4. Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 3.8.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”;
5. Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 18, datë 11.8.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, si dhe romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”;
6. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 6.9.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017”;
7. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 24, datë 7.10.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017”, të ndryshuar.

 FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Vite 2015 – Numri 119	
Tiranë – E premte 10 korrik 2015	
PËRMBAJTJA	
Vendim i Kuvendit nr. 73/2015, datë 27.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 32/2015, “Për krijimin e Komisionit të Posaqim Parlamentar për rishikimin e problematikës në rrethet për marrëveshjen midis bashkëpunimit qeverisës dhe opozitës në Kuvendin e Shqipërisë”.
Vendim i Kuvendit nr. 74/2015, datë 27.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 32/2015, “Për krijimin e Komisionit të Posaqim Parlamentar për rishikimin e problematikës në rrethet për marrëveshjen midis bashkëpunimit qeverisës dhe opozitës në Kuvendin e Shqipërisë”, si ndryshuar.
Rezolutë e Kuvendit datë 27.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2014.
Udhëzimi i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 26, datë 6.7.2015	Për ligjetin e si ardhurave individuale për efekt të përcaktimit të moshës së pensionist social.
	Faqe:
	6243
	6243
	6243
	6244

7 p/ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim pranë Komisionerit tashmë të miratuara dhe botuara në Fletore Zyrtare 2016.

15 akte nënligjore (p/vendime dhe p/udhëzime) të cilat nuk janë paraqitur për mendim pranë Komisionerit tashmë të miratuara dhe botuara në Fletore Zyrtare.